



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr 45 date 27/04/2001

**MBI**

**PAGESEN E KUOTES SE ANETARESISE SE BASHKISE TIRANE NE  
SHOQATEN E BASHKIVE TE SHQIPERISE**

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, neni 8, paragrafi V, gërma c, si dhe në mbështetje të Kartës Europiane të Autonomisë Lokale, neni 10, pika 1 dhe 2, Ligjit Nr.8654 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Tiranë”, Ligjit “Për buxhetin lokal në Republikën e Shqipërisë” me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe Shoqatës së Kryetarëve të Bashkisë, Këshilli Bashkiak

**V E N D O S I**

1. Të miratojë akordimin e shumës prej 300.000 (treqind mijë) lekësh, si kuote anëtarësie për Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë, për periudhën 01 Tetor 2000-01 Tetor 2001
2. Kjo shumë do të depozitohet në llogarinë bankare nr.9605/110 të Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe të përballohet brenda fondit të miratuar të Drejtorisë së Përgjithshme të Burimeve Njerëzore dhe Informacionit
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**